



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 691, Datë 22/12/2014

“PËR

**FILLIMIN E PROCESIT, TË PËRCAKTIMIT TË KRITEREVE DHE  
PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE, TË  
REGJISTRUESVE TË ZYRAVE VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME DHE TË TESTIMIT TË AFTËSIVE PROFESIONALE TË  
PERSONELIT TË KËTYRE ZYRAVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Kryeregjistruesi të hartojë dhe t'i propozojë për miratim Bordit Drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kriteret dhe procedurat për certifikimin e aftësive profesionale të regjistruesve të Zyrave së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të testimit të aftësive profesionale të personelit të këtyre zyrave.
2. Propozimi, sipas pikës 1 të këtij urdhëri t'i paraqitet Bordit Drejtues, brenda datës 31.12.2014.
3. Ngarkohet Kryeregjistruesi që brenda 60-ditëve nga miratimi i kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij urdhëri, të marrë masat e nevojshme për realizimin e testimit/certifikimit të aftësive profesionale të të gjithë drejtuesve dhe punonjësve, sipas procedurës të miratuar.

4. Ngarkohet Kryeregjistruesi që brenda 30-ditëve nga kryerja e testimit të njoftojë rezultatet përfundimtare të tij. Ky informacion do t'i përcillet Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë, Bordit Drejtues dhe personave të interesuar.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**

